

BASHKIA KAVAJË

KRYETARI
Fisnik QOSJA

Nr. _____ Prot.

Kavajë, më __. __. 2025

Lëndat: Dërgohet material për shqyrtim e miratim.

Z.

KRYETAR I KËSHILLIT BASHKIAK RUDIN HYLYIU

Federuar zotë Kryetar.

Bashkëngjitur, po ju dërgojmë projekt - vendimin dhe relacionin shoqërues për:

"MIRËNDRYSHIMIN PËSËRISHT TË VENDIMIT NR. 09, DATË 26.03.2025"

Më respekt,

KRYETARI
Fisnik QOSJA



Koncepti:

Komisioni i Posaçëm për shqyrtimin e dokumentacionit, vlerësimin dhe rivlerësimin e dosjeve, të aplikuar nga qytetarët, për miratimin e procesit të rindërtimit në Bashkinë Kavajë:

Julian HOXHA

Nr. 1 fletëveshtje të projekt-vendimit: 2

Nr. 1 fletëveshtje të relacioni shoqërues: 2

Geni GYLSHENTI

Erdi BERATI



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA KAVAJË**

Kavajë, më __. __. 2025

**PROJEKT – VENDIM
Nr. __, datë __. __. 2025**

“MBI NDRYSHIMIN PJESËRISHT TË VENDIMIT NR. 09, DATË 26.03.2025”

Në mbështetje të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, Kodi të Procedurës Administrative, Ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” të ndryshuar, Ligjit Nr. 45/2019 “Për mbrojtjen civile”, në Aktin Normativ të Këshillit të Ministrave Nr.9, datë 16.12.2019 “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”, Vendimit nr. 750, datë 27.11.2019 të Këshillit të Ministrave “Për shpalljen e gjendjes së fatkeqësisë natyrorenë qarqet Durrës dhe Tiranë” të ndryshuar, Vendimit nr.887, datë 24.12.2019 “për përcaktimin e rregullave dhe procedurës së përshpejtuar për hartimin dhe miratimin e planit të detyruar vendor, si dhe procedurës së miratimit të lejeve të zhvillimit/ndërtimit, në rastet e fatkeqësive natyrore”, VKM nr. 904, datë 24.11.2019 “Për përcaktimin e rregullave, të kategorive prioritare, masës së përfitimit, autoriteteve përgjegjëse dhe procedurave për vlerësimin dhe përzgjedhjen e përfituesve nga disa programe të procesit të rindërtimit” i ndryshuar .

TË VENDOSI:

- Miratimin e ndryshimit të VKB Nr. 09, datë 26.03.2025 sipas Lidhjes Nr.1, duke ndryshuar tipologjinë e përfitimit nga grant 1+1, në apartament për subjektin përfitues Durim Haxhi Kasa.

Lidhja nr.1

Nr.	Emër Atësi Mbiemër	Masa përfitimit ishte	VKB i mëparshëm	NR.PERSONAVE GJITHSEJ	Masa e përfitimit bëhet	Vlera
1	Durim Kasa	Grant 1+1	Nr. 09 Lidhja Nr. 1 VKB nr. 09, dt. 26.03.2025	2+3	Apartament 2+1	



-Ky Projekt – Vendim, pasi të miratohet nga Këshilli Bashkiak, hyn në fuqi sipas parashikimeve të pikës 6 të nenit 55 të ligjit nr. 139, datë 17.12.2015, “Për vetëqeverisjen vendore”

DREJTORIA LIGJORE

Adrian MALAJ

SEKTORI I EMERGJENCAVE CIVILE

Dritan KAZAZI

DREJTORIA E BURIMEVE EKONOMIKE

Andi ÇURGU

DREJTORIA E PLANIFIKIMIT DHE ZHVILLIMIT TË TERRITORIT

Dëshira QATO

SEKRETAR I KËSHILLIT BASHKIAK

Meri BITURKU

KRYETARI

Fisnik QOSJA



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA KAVAJË

Nr. ____ Prot.

Datë, __. __. 2025

Lënda: Raport mbi propozimin e ndryshimit pjesërisht të VKB Nr.09, datë 26.03.2025

Kryetarit të Bashkisë
Z. Fisnik Qosja

Komisioni i ngritur me Urdhërin nr. 31, me Nr. 604 Prot., më datë 05.02.2025, „Për një ndryshim të Urdhërit nr. 917, datë 12.12.2023 “Per ngritjen e Komisionit te Posacem për shqyrtimin e ankesave të disa qytetarëve të cilët kanë qenë përfitues me VKB dhe për mbylljen e procesit të rindërtimit në Bashkinë Kavajë“ kanë shqyrtuar të gjithë dokumentacionin që administrohet në dosjet e aplikimeve të çdo qytetari.

Komisionet janë bazuar ne Aktin Normativ nr. 9, datë 16.12.2019, të Këshillit të Ministrave, “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”, të ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, të ndryshuar, të ligjit nr. 45/2019, “Për mbrojtjen civile”, Vendimit nr. 750, datë 27.11.2019, të Këshillit të Ministrave “Për shpalljen e gjendjes së fatkeqësisë natyrore në qarqet Durrës dhe Tiranë”, të ndryshuar, Vendimit nr. 887, datë 24.12.2019 “Për përcaktimin e rregullave dhe procedurës së përsheptuar për hartimin dhe miratimin e planit të detyruar vendor, si dhe procedurës së miratimit të lejeve të zhvillimit/ndërtimit, në rastet e fatkeqësive natyrore”, Vendimit nr. 904, datë 24.12.2019 “Për përcaktimin e rregullave, të kategorive prioritare, masës së përfitimit, autoriteteve përgjegjëse dhe procedurave për vlerësimin dhe përzgjedhjen e përfituesve nga disa programe të rindërtimit” Vendimit nr. 5, datë 6.1.2020, të KM, “Për përcaktimin e rregullave dhe të procedurave për përfitimet nga programi i granteve të rindërtimit dhe projektet model” i ndryshuar, Vendimeve të KM të cilat kanë dalë në zbatim të Aktit Normativ nr. 9, datë 16.12.2019, të Këshillit të Ministrave, Kodin e Procedurave Administrative, në Ligjin Nr. 8480, datë 27.05.1999 “Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike” dhe akt-ekspertizës së Institutit të Ndërtimit.

Kërkesat e plotësuara me të dhënat dhe dokumentacionin sipas parashikimit të këtij vendimi regjistrohen sipas rendit kronologjik në sistemin e posaçëm elektronik nga strukturat përgjegjëse. Regjistri i kërkesave përmban informacionin që mundëson përpunimin e të dhënave, si më poshtë vijon:

- a) emrin, atësinë, mbiemrin;
- b) numrin e kërkesës;
- c) datën e dorëzimit/paraqitjes së aplikimit;



- ç) objektin e kërkesës, përfshirë edhe preferencën e paraqitur për programin e rindërtimit;
- d) adresën e kërkuarit;
- dh) përbërjen familjare në momentin e aplikimit;
- e) Aktin e konstatimit/akt-ekspertizën e thelluar, të lëshuar nga çdo person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës tregtare, i pajisur me lejen, licencën ose autorizimin përkatës nga autoritetet shtetërore për vërtetimin e gjendjes së rrezikut për jetën dhe shëndetin, në të cilin vërtetohen dëmet që ka pësuar ndërtesa apo që është shpallur si e pabanueshme;
- ë) dokumentin e pronësisë ose çdo akt për fitimin e pronësisë së banesës së dëmtuar.

Të gjitha familjet që do të listohen përfituese, do të përfitojnë grante nga programet e rindërtimit, apo strehim në apartamentet e ndërtuara për kategoritë përkatëse.

Janë kualifikuar fitues kategoritë e subjekteve që shtëpitë e tyre janë me dokument pronësie, gjithashtu janë klasifikuar përfitues nëpërmjet grantit të rindërtimit familjet e dëmtuara nga fatkeqësitë natyrore, shtëpitë e banimit individuale të të cilëve janë klasifikuar si objekte të dëmtuara me shkallë dëmtimi DS1, DS2, dhe DS3, duke marrë parasysh udhëzimet e pikës 13 të VKM nr. 5 datë 06.01.2020, dhe konkretisht të gjurmës “ë”, ku çdo lloj dokumentacioni që provon të drejtat e pronësisë mbi objektin e dëmtuar, si vërtetime nga ASHK për aplikime legalizimi, vërtetime që kanë shtëpi banimi, por të paregjistruar në ASHK apo kontratat e dritave të lidhura ndërmjet OSHE-së dhe familjarëve të shtëpive të dëmtuara është marrë parasysh nga komisionet. Për përfituesit e objekteve individuale dhe të apartamenteve është marrë parasysh përbërja familjare sipas certifikatave së gjendjes familjare në momentin e rënies së tërmetit të datës 26.11.2019.

Më poshtë po japim disa shpjegime sipas kategorive përfituese për rivlerësim:

- Lista e përfituesve për të cilët rishikohet masa e përfitimit

Në tabelën e mëposhtme pasqyrohet familja e së cilës, i është rishqyrtuar dosja dhe ka plotësuar me dokumentacionet e nevojshme për rivlerësim pas momentit të aplikimit për formularët e përfitimit të granteve të rindërtimit. Vendimi i komisionit për këtë familje është sipas tabelës më poshtë:



Lidhja nr.

Nr.	Emër Atësi Mbiemër	Masa përfitimit ishte	VKB i mëparshëm	NR. PERSONAVE GJITHSEJ	Masa përfitimit bëhet	Vlera
1	Durim Haxhi Kasa	Grant 1+1	VKB nr. 09, dt. 26.03.0225	2+3	Apartament 2+1	

Specifikisht, në numrin rendor 1, të rishikohet masa e përfitimit të tipologjisë nga grant 1+1 sipas lidhjes 1, të Vendimit të Këshillit Bashkiak nr. 09, dt. 26.03.2025, në apartament 2+1 për subjektin përfitues Durim Haxhi Kasa, duke marrë parasysh faktin që numri I anëtarëve është 5 gjithsej. Në këtë rast, për shkak të problemeve me bashkëpronësinë si dhe pamundësinë për të rindërtuar në po të njëjtin territor për shkak të hapësirës së pamjaftueshme, në marrjen e këtij vendimi, komisioni u bazua në plotësimin e dokumentacionit nga ana e aplikantit me vërtetim banori lagjeje të shoqëruar me certifikatën familjare të momentit të rënies së tërmetit të datës 26.11.2019.

Përmbledhëse

Komisioni ka marrë parasysh të gjithë ecurinë e procesit të rindërtimit. Në shqyrtimin e dosjeve janë hulumtuar për plotësim dokumentacioni me akt-ekspertizë nga Instituti Ndërtimit në secilën dosje të formularëve të aplikimeve për grantet e rindërtimit. Duke qenë se dinamika e procesit është kushtëzuar nga bashkëpunimi mes një sërë institucionesh dhe secili institucion ka angazhuar sektorë të posaçëm në trajtimin e këtij procesi, disa dosje të formularëve të aplikimit për të përfituar nga program i formularëve të rindërtimit si pasojë e tërmetit të datës 26.11.2019, kanë qenë në pritje të akt-ekspertizave përkatëse, si edhe oponencave të projekteve të rforcimit në rastet kur rekomandimi fillestar ka qenë për ndërhyrje konstruktive dhe riparime. Gjithashtu, është e rëndësishme të mbahet parasysh fakti që shkallët e dëmtimit Ds-1, Ds-2 dhe Ds-3 nuk kanë pasur kusht akt-ekspertimin pasi konstatimet janë kryer nga komisionet e ngritura pranë Bashkisë dhe Njësive Administrative Vendore. Edhe në këto raste, në disa aplikantë, ka pasur ankesa dhe vetë Njësia Vendore, ka kërkuar Insitutit të Ndërtimit ekspertizë më të thelluar në një kohë të dytë pas ekspertimit të aplikantëve që ishin listuar në momentin e parë të konstatimit me shkallë dëmtimi Ds-4. I gjithë ky proces, është ndjekur nga komisioni për të bërë ndryshimet dhe shtesat përkatëse të VKB-ve të mëparshme.

Gjithashtu, për sa i përket objekteve me shkallë dëmtimi Ds-4 dhe Ds-5, të përcaktuara në akt-konstatimet e komisioneve të ngrituara pranë njësive vendore, fillimisht, objektet e rekomanduara për prishje nga Insituti Ndërtimit u kualifikuan si pjesë e objekteve të rindërtimit me njësi zbatimi FSHZH, por vetëm një pjesë e përfituesëve të kualifikuar u përfshin në këtë proces. Rrjedhimisht, procesi u zhvillua nëpërmjet lëvrimit të granteve të rindërtimit për sa i përket objekteve individuale të banimit.

Përpos ndërveprimeve me Institucionet, Njësitë Vendore Administrative të Bashkisë, nëpërmjet Komisioneve, kanë shqyrtuar rast pas rasti dokumentacionin pasi edhe problematikat në lidhje me pronësinë dhe ndërtimet informale janë komplekse. Gjithashtu, informacioni shtesë i mbledhur në lidhje me kontratat aktive të energjise elektrike të lidhura me OSHEE-në ju njoftua qytetarëve në një kohë të dytë pasi aplikimet ishin kryer. Sikurse është sipërcituar edhe mësipër, kriteri bazë janë certifikatat familjare të gjendjes civile të datës 26.11.2019 i cili është edhe momenti I rënies së tërmetit.

Sikurse është përshkruar më lart, duke pasur parasysh kompleksitetin e procesit ku një sërë insitucionesh janë përfshirë dhe kanë punuar në rrethanat e emergjencave civile në nivel rajonal, raste të veçanta të kualifikuarish pozitivisht dhe që janë në listat e përfituesëve të granteve të rindërtimit kanë mbetur pezull si pasojë e mungesës së dokumentacioneve përkatëse të pronësive, dhe madje, edhe në rastet kur njësia zbatuese ka qenë në proceset paraprake të përgatitjes për zbatimin e punimeve, pa nisur punimet, janë hasur me problematika që lidhen rrethana konkrete si aksesit nga mjetet e rënda të ndërtimit për në objektet e përfituesëve, ndodhja e strukturave ekzistuese shumë pranë strukturave të tjera ngjitur dhe pamundësia për të shmangur dëmtimin e tyre në rast ndërhyrjeje. Raste të caktuara familjesh përfituese, me pretendimin që kanë qenë të pa informuara nga njësia administrative vendore për rëndësinë e pasqyrimit të gjendjes së plotë civile në formularët e aplikimit për aplikimin mbi grantet e rindërtimit, kanë depozituar pranë Bashkisë certifikatat familjare përkatëse dhe ndërkohë që ishin në pritje të rishqyrtimit të dokumentacionit apo rivlerësimit të masës së përfitimit nuk kanë ndërmarrë nismën për aplikim për leje ndërtimi në rastet e granteve individuale të rindërtimit, apo nuk kanë marrë në dorëzim apartamentin në rastet e strehimit në apartamente banimi.

Anëtarët e Komisionit

Julian Hoxha



Genci Gjylsheni



Erdi Berati

